

VIENNA JETË
VIENNA INSURANCE GROUP

Raporti Vjetor
2025



Thuaj jetës PO!

Vienna Insurance Group – (VIG)	4-5-6	Zhvillimet në Treg	16-17
Historiku I Vienna Life Insurance	7-8	Pasqyre makroekonomike	18-19
Vizioni dhe Misioni i Vienna Life	9	Rezervat Teknike dhe Matematike	20-21
Struktura e Vienna Life Insurance	10	Menaxhimi i Riskut	22-25
Struktura e Vienna Life Insurance	11	Raporti i Auditit të Brendshëm	26-30
Produktet Tona	12	Raporti I Pasqyrat Financiare	31-34
Stafi I Vienna Life	13-14	Plani për 2026	35-37
Tregu i Sigurimeve në Shqipëri - 2025	15	Kontakt	38

Vienna Insurance Group (VIG)

Vlerat tona



Pluralizmi



Sipërmarrja



Përgjegjësia



Ekselencia



Pasioni

Grupi ynë – Vienna Insurance Group

- ❑ I themeluar në vitin 1824 me mbi 200 vjet përvojë në industri
- ❑ Grupi lider i sigurimeve në Austri dhe në rajonin e Evropës Qendrore & Lindore
- ❑ Rreth 16.31 miliardë € primet e shkruara bruto (2025)
- ❑ Mbi 30,000 punonjës në nivel grupi
- ❑ 33 milionë klientë
- ❑ Aktiv në 30 vende me ~50 kompani sigurimesh
- ❑ Bashkëpunim me Erste Group, bankën më të madhe retail në Evropën Qendrore dhe Lindore

Pozicioni në Treg:

- ❑ Grupi lider i sigurimeve në Austri
- ❑ Prani e konsoliduar dhe në rritje në të gjithë rajonin CEE

Pozicion Financiar i Qëndrueshëm:

- ❑ Vlerësim A+ (perspektivë e qëndrueshme) nga Standard & Poor's
- ❑ Listuar në Bursat e Vjenës, Pragës & Budapestit (Indeksi ATX)
 - Stabilitet financiar i provuar
 - Bazë e fortë kapitali
 - Partner i besueshëm afatgjatë

Vienna Insurance Group (VIG)

Vienna Insurance Group, me seli të regjistruar në Vjenë, Austri, është një nga grupet më të mëdha ndërkombëtare të sigurimve në Evropën Qendrore dhe Lindore, me mbi 29,000 punonjës në 50 shoqëri të shpërndara në 30 shtete.



Numer 1 in CEE

A+
rating with stable
outlook from
Standard & Poor's



Vienna Insurance Group (VIG)

Nr.1

- Austri
- Baltic States
- Republika Çeke
- Hungaria
- Maqedonia e Veriut
- Rumania
- Sllovakia

Top 5

- Shqipëri
- Bosnje Hercegovina
- Bullgari
- Kroaci
- Moldavi
- Poloni
- Serbi
- Ukraina

Top 10

- Kosova
- Mali I Zi
- Sllovenia



Historiku i Vienna Life Insurance

2024

Vienna Life Insurance – Vienna Jete u themelua në Shqipëri dhe mori licencën nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) më 24 dhjetor 2024. Kjo shënoi hyrjen e Vienna Insurance Group në tregun shqiptar të sigurimeve të jetës.

2024-2025

Vienna Life nisi aktivitetin si pjesë e Vienna Insurance Group (VIG), një nga grupet më të mëdha të sigurimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore. Kompania plotëson praninë e VIG në Shqipëri, ku operojnë edhe Sigma dhe Intersig, duke u fokusuar ekskluzivisht në sigurimet e jetës, sigurimet shëndetësore, kursimet dhe produktet e pensionit.

2024 – Sot

Aktualisht, VIG zotëron 75% të aksioneve dhe Noa Holding zotëron 25% të aksioneve të Vienna Life. Vienna Life Insurance. Kompania synon të forcojë tregun shqiptar të sigurimeve duke sjellë produkte inovative të sigurimit të jetës, duke promovuar mbrojtjen afatgjatë financiare, shëndetësore dhe duke mbështetur zhvillimin e produkteve të kursimit.



Vienna Life Insurance – Kush jemi ne?



Struktura Financiare & Pronësie:

Kapitali aksionar: ALL 468,000,000

- ❖ 75% Vienna Insurance Group (Austri)
- ❖ 25% NOA Holding

Fakte Kryesore:

- ❖ Pjesë e Vienna Insurance Group, një nga grupet lider të sigurimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore
- ❖ Ofron zgjidhje sigurimi të cilësisë së lartë dhe të orientuara drejt klientit
- ❖ Kombinon standardet ndërkombëtare me ekspertizë të fortë lokale Pika jonë e fortë:
- ❖ Mbështetur nga ekspertiza ndërkombëtare dhe standarde të larta
- ❖ Shërbim i besueshëm, i qëndrueshëm dhe i fokusuar te klienti

Vienna Life ofron zgjidhje të përshtatura sigurimi për institucionet, të dizajnuara me kujdes për të plotësuar nevojat e tyre specifike duke siguruar mbulim të plotë dhe besueshmëri afatgjatë.

Vizioni dhe Misioni i Vienna Life - VIG

Vizioni

Të bëhemi leader në fushën e sigurimeve dhe shërbimeve financiare, duke ndjekur rritjen e qëndrueshme dhe duke maksimizuar vlerën e kompanisë. Synojmë të jemi zgjedhja kryesore si kompani sigurimesh, të përkushtuar në edukimin, shërbimin dhe mbrojtjen e familjeve dhe bizneseve, duke ofruar mbulime më të përshtatshme me çmimin të drejtë. Vizioni ynë është të vendosim një standard të lartë cilësie në tregun e sigurimeve, përmes inovacionit, stabilitetit financiar dhe angazhimit maksimal ndaj nevojave të klientëve tanë.

Misioni

Të ofrojmë produkte dhe shërbime të sigurimit të jetës dhe shëndetit me standardet më të larta profesionale, duke kombinuar ekspertizën ndërkombëtare të Vienna Insurance Group me nevojat e tregut shqiptar. Angazhohemi të ndërtojmë marrëdhënie afatgjata me klientët tanë, të promovojmë sigurinë financiare dhe të kontribuojmë në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit.

Premtimi yne: **Thuaj jetës PO!**

Premtimi i VIG: **Protecting What Matters!**

VIENNA JETË 
VIENNA INSURANCE GROUP



Struktura e Vienna Life Insurance

Vienna Life - Vienna Insurance Group operon në tregun shqiptar prej Dhjetorit 2024 në fushën e sigurimit të jetës.

Struktura e Këshillit Mbikëqyrës

Keshilli Mbikeqyres

Z. Christoph Rath	Kryetar
Z. Peter Höfinger	Anëtar
Z.Andrija Pešić	Anetar
Z.Gerhard Kalcik	Anëtar
Znj. Fitnete Sula	Anëtare


Struktura e Bordit Drejtues

- Znj. Albana Meta
- Administratore

Struktura e Aksionarëve

- Vienna Insurance Group75 %
- Noa Holding25 %

Struktura e Vienna Life



Vienna Life Insurance – VIG – Produktet Tona

Ne ofrojmë një gamë zgjidhjesh sigurimi të projektuara për të ofruar mbrojtje, siguri financiare dhe qetësi mendore në situata të ndryshme jetësore.

Sigurimi I Shëndetit & Jetës	Sigurimi I Jetës	Sigurimi I Udhëtimeve	Sigurimi nga Aksidentet Personale
❖ Mbulon shpenzimet mjekësore që rrjedhin nga sëmundje të papritura ose aksidente ❖ Lehtëson aksesin në shërbimet shëndetësore ❖ Ndiemon në reduktimin e barrës financiare nga kostot e papritura mjekësore	❖ Ofron mbrojtje financiare në rast të vdekjes natyrale ❖ Siguron mbështetje financiare për familjarët dhe përfituesit ❖ Ndiemon në garantimin e stabilitetit financiar afatgjatë	❖ Mbulon shpenzimet mjekësore për udhëtarët jashtë Shqipërisë ❖ Ofron mbrojtje gjatë udhëtimeve ndërkombëtare ❖ Përfshin asistencë mjekësore emergjente jashtë vendit	❖ Mbulon humbjen e jetës si pasojë e aksidentit ❖ Mbulon paaftësi të përhershme ose të përkohshme ❖ Mbulon shpenzimet mjekësore të shkaktuara nga aksidentet ❖ Ofron kompensim ditor gjatë periudhës së paaftësisë për punë

Vlerat Kryesore:

Ne mbështesim individët dhe institucionet duke ofruar mbrojtje në fushat e shëndetit, jetës, udhëtimeve dhe aksidenteve, duke ndihmuar në sigurimin e stabilitetit financiar në situata të papritura përmes zgjidhjeve fleksibël të përshtatura sipas nevojave të ndryshme.

Stafi i Vienna Life - VIG

Një kujdes i veçantë i kushtohet trajnimit të vazhdueshëm brënda dhe jashtë vendit të punonjësve tanë , në mënyrë që t'liu ofrojmë klientëve në çdo kohë shërbimin e duhur profesional.



Stafi i Vienna Life - VIG

Një kujdes i veçantë i kushtohet motivimit të vazhdueshëm të punonjësve tanë.
Staff Retreat




Tregu i Sigurimeve në Shqipëri - 2025


- ❖ Gjatë vitit 2025, tregu i sigurimeve në Republikën e Shqipërisë vijoi trendin pozitiv të rritjes. Të ardhurat nga primet e shkruara bruto arritën në **27.09 miliardë lekë**, duke shënuar një rritje prej **10.54%** krahasuar me vitin 2024. Numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në **1,676,640**, me një rritje prej **5.07%** krahasuar me një vit më parë.
- ❖ Tregu mbeti i orientuar kryesisht drejt sigurimeve të Jo-Jetës, të cilat përbënin **90.99%** të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës zinin **8.99%** të tregut.
- ❖ Segmenti i sigurimeve të jetës vijoi një ecuri pozitive gjatë vitit 2025. Primet e shkruara bruto arritën në **2.44 miliardë lekë**, duke shënuar një rritje prej **17.62%** krahasuar me vitin 2024, ndërsa numri i kontratave u rrit me **21.67%**, duke arritur në **185,833** kontrata. Ky segment u rrit me ritme dukshëm më të larta se tregu në tërësi, duke konfirmuar potencialin e tij të zhvillimit.
- ❖ Tregu shqiptar i sigurimeve mbetet një sektor me perspektiva pozitive rritjeje dhe me rol gjithnjë e më të rëndësishëm në mbrojtjen financiare të individëve dhe në zhvillimin e ekonomisë së vendit.

Zhvillimet në treg

Market GWP – total




Market GWP – Life



Përmbledhje e rezultateve financiare – IFRS (në mijë lekë)


GWP




In 31.12.2024 the value of GWP was 0

Pasqyrë makroekonomike


Rritja/Rënia vjetore e PBB-së reale të Shqipërisë sipas tremujorëve (%)



Ecuria e normës së inflacionit në Shqipëri




Kurba e rendimentit të obligacioneve qeveritare shqiptare




SHPERNDARJA E PORTOFOLIT NE TREG

IFRS

Struktura e portofolit sipas primeve bruto të shkruara – Tregu kundrejt VIG




Vienna Life Insurance



- Jeta e Debitorit
- Sigurim me përfitim vetëm në maturim
- Sigurim i kombinuar jete
- Sigurim jete dhe shëndetësor
- Jeta në Grup
- Jeta e Studentit
- Sigurim i jetës për nxënës dhe studentë
- Sigurim jete me kursim
- Plan fleksibël
- Plan rimbursimi në para
- Te tjera

REZERVAT TEKNIKE DHE MATEMATIKE

Rezervat teknike dhe matematike bruto (në mijë lekë)




Te Ardhura nga Investimet

Të ardhurat nga investimet sipas klasës së aktiveve – IFRS (në mijë lekë)

Te ardhura nga investimet



Kthimi mesatar vjetor i investimit



- Të ardhurat nga investimet e shoqërisë përbëhen nga interesat e gjeneruara nga depozitat me afat.

Garanci për çdo risk

Vienna Life Insurance, si pjesë e Vienna Insurance Group (VIG), mbështetet nga standarde të larta të menaxhimit të riskut, qeverisjes korporative dhe stabilitetit financiar. Kjo u ofron klientëve siguri dhe besueshmëri afatgjatë në përmbushjen e detyrimeve kontraktore.

Nëpërmjet nënshkrimit të Marrëveshjeve të Risigurimit përsa i përket produkteve të sigurimit të jetës, Shoqëria Vienna Life - VIG ofron për klientët e saj, në përputhje me Liçencën e Ushtrimit të Aktivitetit, garanci të plotë për çdo risk.

VIG Group me qendër në Pragë, Çeki, është shoqëria e risigurimit të grupit VIG, e cila mbështet të gjitha shoqëritë e grupit dhe më tej.

Marrëveshjet e Risigurimit, i mundësojnë shoqërisë transferimin e rrezikut në shoqëritë e mëdha të Risigurimit. Marrëveshjet e Risigurimit mundësohen nga VIG RE si dhe nga Risigurues të tjerë, të gjithë të vlerësuar me “A+” nga Standard & Poor’s, gjë që e bën Vienna Insurance Group shoqërinë më të vlerësuar në indeksin kryesor ATX të Bursës së Vjenës që nga viti 1994, në Bursën e Pragës që nga viti 2008 dhe në Bursën e Budapestit që nga nëntori 2022.


Procesi i Vlerësimit të Riskut

Këto janë risqet (përfshirë dhe kategoritë e nën-risqeve) tek të cilat fokusohet dhe analiza e vetëvlerësimit.

Risku i marrjes në sigurim

Risku operacional

Risku i tregut



Vlerësimi dhe Menaxhimi i Riskut

Menaxhimi i riskut është pjesë integrale e sistemit të qeverisjes korporative të Vienna Insurance Group. Qëllimi kryesor është ruajtja e stabilitetit financiar dhe përmbushja e detyrimeve ndaj klientëve në çdo kohë.

Risket kryesore të identifikuara:

- ❖ Riskun e nënshkrimit të sigurimeve të jetës dhe shëndetit
- ❖ Riskun e tregut dhe investimeve
- ❖ Riskun e kreditit dhe mospagimit të palëve të treta
- ❖ Riskun operacional
- ❖ Riskun e likuiditetit
- ❖ Riskun e reputacionit
- ❖ Riskun strategjik dhe të përputhshmërisë ligjore
- ❖ Riskun e teknologjisë së informacionit dhe sigurisë kibernetike.

Për menaxhimin e këtyre risqeve, grupi VIG përdor një sistem gjithëpërfshirës të monitorimit dhe raportimit, i mbështetur nga ekspertiza e strukturave të specializuara të riskut dhe risigurimit në nivel grupi.

Vlerësimi dhe Menaxhimi i Riskut

Prova e Rezistencës

Vlerësimi dhe klasifikimi i risqeve dhe kryerja e provave të rezistencës bëhet në bazë skenari dhe në bazë ndjeshmërie ndaj ngjarjes. Nga sa më sipër, kryhet llogaritja e nevojave për kapital shtesë në rast se, gjatë vitit të ardhshëm, ndodhin të gjithë skenarët e menduar të situatave katastrofike, epidemike dhe të krizave financiare.

Administrimi i Kapitalit dhe Niveli i Aftësisë Pague

Vienna Life sigurohet që të mbajë një fond garancie jo më pak se 1/3 e marzhit të aftësisë pague minimale, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

Plani i Vazhdimësisë së Aktivitetit

Vienna Life ka hartuar planin e vazhdueshmërisë së aktivitetit, në të cilin parashikohen skenaret e risqeve të ndryshme të mundshme si dhe masat që duhet të ndërmerren në çdo rast nga personat përgjegjës.

Profili i Përgjithshëm i Riskut

Vienna Life ka marrë masat e nevojshme për mbrojtjen nga pasojat e skenarëve të mësipërm dhe për rrjedhojë, risku i shoqërisë rezulton i menaxhueshëm.

Përmbledhje e aktivitetit të Audituesit të Brendshëm

Auditimet dhe kontrollet e kryera

Auditi i Brendshëm ka kryer auditimin përmbledhës për vitin 2025 në shoqërinë e sigurimit Vienna Life - VIG, i cili është realizuar bazuar në kërkesat e legjislacionit të AMF për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve, politikat dhe rregulloret e VIG Group, dokumentin “Parimet kryesore të Auditit të Brendshëm të Vienna Insurance Group”, rregulloren e AMF “Për veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm për shoqëritë e sigurimit”, si dhe në rregulloret e brendshme të shoqërisë.

Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm për vitin 2025 si viti parë i aktivitetit të saj është përfshirë në veprimtarinë e shoqërisë kryesisht në fushat e Shitjes, Trajtimit të dëmeve, Administrimit Financiar, Kontabilitetit, Marrjes në Sigurim, Menaxhimit të Riskut, Risigurimeve dhe Teknologjisë së Informacionit

Përmbledhje e aktivitetit të Audituesit të Brendshëm

Aktivitetet e Shitjes së Policave të Sigurimit për Produktet e Miratuara dhe të Licencuara nga AMF-ja:

Kontrollet e Auditit të Brendshëm, të cilat janë kryer gjatë këtij viti, janë përqendruar në përputhshmërinë me kërkesat ligjore të AMF-së, rregulloret e brendshme të shoqërisë, kryesisht lidhur me kontrollin e shitjes së produkteve. Në këto kontrolle, vëmendja është përqendruar tek risqet e mundshme që lindin si pasojë e gabimeve në regjistrimin e policave në programin e shitjes MBA, në përdorimin ekskluziv të këtij programi për shitjen e policave, si dhe në saktësinë e të dhënave që lidhen me kohën e regjistrimit të policës, përputhshmërinë e saj dhe periudhën e mbulimit të sigurimit. Janë kontrolluar vlerat e primeve për çdo policë, si dhe primi total vjetor në krahasim me numrin e policave të përdorura dhe të shitura gjithsej. Kjo është realizuar në bazë të planifikimit dhe vlerësimit të riskut, si dhe në përputhje me rregulloret e brendshme për administrimin dhe menaxhimin e shitjeve.

Aktiviteti i Trajtimit të Dëmeve

Funksionet e menaxhimit dhe trajtimit të dëmeve për tre kompanitë, Vienna Life, Intersig dhe Sigma, si pjesë e VIG Group, janë transferuar në kompaninë e shërbimit “VIG Services Shqipëri”. Kontrollet në Departamentin e Trajtimit të Dëmeve janë kryer në përputhje me rregulloret, udhëzimet dhe legjislacionin në fuqi për tregun e sigurimeve, si dhe në përputhje me politikat dhe udhëzimet e VIG Group, dhe rregulloret e brendshme të shoqërisë Vienna Life. Fokus kryesor i kontrollit ka qenë procesi i regjistrimit në kohë dhe plotësimi i dokumentacionit të dëmit, si dhe kohëzgjatja e trajtimit të dëmeve dhe zbatimi i afateve ligjore për pagesën e dëmshpërblimit ndaj përfituesve të dëmit apo klientëve. Gjithashtu, është vlerësuar zbatimi i kërkesave ligjore dhe rregulloreve të AMF-së, si dhe zbatimi i rregulloreve të brendshme të shoqërisë dhe të vetë departamentit të Dëmeve në VIG Services.

Përmbledhje e aktivitetit të Audituesit të Brendshëm

Aktiviteti i Administrimit Financiar, Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar:

Funksionet dhe proceset e punës së administrimit financiar realizohen në zyrat qendrore të kompanisë Vienna Life - VIG, ndërsa departamenti i Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar ushtron veprimtarinë e tij në kompaninë e shërbimeve Vig Services Shqipëri.

Gjatë vitit 2025, kontrollet në departamentin e Administrimit Financiar janë fokusuar në menaxhimin dhe administrimin e policave të sigurimit për të gjitha proceset që kalon një policë sigurimi në programin MBA, si: furnizimi dhe shpërndarja e policave, regjistrimi në programin e shitjes nga departamenti i shitjes, agjentët, zyrat dhe ndërmjetësit e tjerë të shitjes, deri te arkëtimi i primeve dhe rakordimet përkatëse.

Temat kryesore të audituara për vitin 2025 kanë qenë: raportet për menaxhimin e primeve, arkëtimin e tyre, raportet e debitorëve dhe të inventarit fizik dhe kontabël të policave të detyrueshme të nxjerra nga programi i shitjes MBA. Janë kryer gjithashtu kontrole në lidhje me llogaritjen e komisioneve bazuar në kërkesat ligjore të AMF-së, si dhe në përputhje me urdhrat e brendshëm të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë.

Në veprimtarinë e Kontabilitetit në Vig Services, kontrollet janë përqendruar në saktësinë e regjistrimeve në programin Bilanc, për primet e shkruara, primet e arkëtuara dhe balancat e hapura debitorë për primet e paarkëtuara, në nivel kompanie, dege dhe agjentësh të tjerë shitjeje. Janë kontrolluar rakordimet mujore dhe vjetore të nënshkruara nga të dy departamentet, të cilat synojnë krahasimin e të dhënave dhe treguesve të raportuar në programin Bilanc me ato të raportuar në programin MBA. Nga kontrolli ka rezultuar se të dhënat janë korrekte dhe të nënshkruara nga personat përgjegjës për të dyja palët.

Përmbledhje e aktivitetit të Audituesit të Brendshëm

Aktivitetet e Marrjes në Sigurim dhe të Menaxhimit të Rrezikut

Janë kryer kontrole lidhur me treguesit dhe nivelet e marrjes në sigurim, si dhe me përcaktimin e rreziqeve për çdo produkt dhe për çdo kontratë sigurimi të caktuar. Gjithashtu, janë kryer kontrole lidhur me të dhënat, analizën dhe përshkrimin e klientit.

Vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut kryhen nga Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut. Ky Komitet kontrollon dhe miraton vlerësimin e rrezikut dhe ofertat për përcaktimin e primit të marrjes në sigurim, bazuar në rregulloret e brendshme, urdhrat dhe udhëzimet e Bordit Drejtues të shoqërisë, si dhe në përputhje me kërkesat e tregut të sigurimeve dhe kërkesat ligjore të AMF-së.

Aktivitetet e Risigurimeve

Këto aktivitete kryhen nga Departamenti i Risigurimeve Share Services, i cili kryen funksionet e tij të shërbimit për kontratat **Treaty** për tri shoqëritë e sigurimit: Vienna Life, Intersig VIG dhe Sigma VIG. Partneri kryesor i shoqërisë për aktivitetin e risigurimeve është VIG RE, i cili është pjesë e Vienna Insurance Group.

Auditimet dhe kontrollet janë kryer kryesisht lidhur me miratimin e limiteve të cedimit të primit për kompanitë e grupit, ku bën pjesë edhe shoqëria Intersig, bazuar në rregulloret e Grupit VIG, të përcaktuara nga departamenti përkatës i Grupit VIG.

Janë kryer auditime për çështjet që lidhen me periudhën e mbulimit në marrëveshjet e risigurimit dhe ka rezultuar se periudha e mbulimit në sigurimet e nënshkruara sipas marrëveshjeve fakultative me risiguruesin është e njëjtë me periudhën e mbulimit në policën e risiguruarit dhe me marrëveshjen e lidhur me klientët ose subjektet e risiguruara.

Përmbledhje e aktivitetit të Audituesit të Brendshëm

Aktiviteti i Menaxhimit të Rrezikut – Sistemi i Qeverisjes së Shoqërisë

Auditimi u fokusua në proceset e punës që kryhen për hartimin e strategjisë së menaxhimit të rrezikut, duke përfshirë identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e rreziqeve, si dhe masat e marra për parandalimin dhe zbutjen e tyre.

Monitorimi dhe raportimi kanë qenë në përputhje me kërkesat rregullatore të AMF-së, politikat e Grupit VIG, si dhe me rregulloret dhe udhëzimet e shoqërisë. Menaxhimi i rrezikut, si pjesë e sistemit të qeverisjes, ka luajtur një rol efektiv në qëndrueshmërinë dhe rritjen financiare të shoqërisë, si dhe ka mbështetur arritjen e objektivave strategjike dhe operative të saj për vitin 2025.

Aktivitetet e Departamentit Ligjor

Auditimet e kryera në aktivitetet juridike dhe ligjore gjatë vitit 2025 janë fokusuar në parandalimin, mbrojtjen dhe përfaqësimin e shoqërisë në proceset gjyqësore me palët e treta, persona fizikë dhe juridikë.

Janë kontrolluar trajtimi i dosjeve të dëmeve gjyqësore, mbrojtja e ofruar në gjykatë, si dhe dhënia e mendimeve juridike për mënyrat dhe rrugët më efektive të zgjidhjes së çështjeve, duke u bazuar, kur ka qenë e mundur, në zgjidhjen me marrëveshje ndërmjetësimi, pa kaluar në proces gjyqësor.

Gjithashtu, janë audituar përfaqësimet e juristëve të shoqërisë lidhur me grumbullimin dhe arkëtimin e primeve të paarkëtuara nga klientët dhe subjektet debitore. Janë audituar edhe procedurat për ndjekjen e dëmeve të regresit, lidhur me arkëtimin e shumave nga klientët për pagesat e dëmeve të kryera, në përputhje me kërkesat ligjore.

Nga auditimet e kryera për vitin 2025 rezultoi se nuk janë konstatuar dëme materiale në shoqërinë Vienna Life.

Opinion i Shoqërisë Audituese



Grant Thornton Sh.p.k
Rr. "Sami Frashëri",
Kompleksi T.L.D, Shk. B, Flok
1
1001 Tirana
Albania
T +355 44 525 880
E contact@al.gt.com

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionarët e Vienna Life Insurance sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Vienna Life Insurance sh.a. (këtu e më poshtë referuar si "Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet mbi pasqyrat financiare, të cilat përfshijnë informacionin material mbi politikat kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2025, performancën e saj financiare dhe flukset e saj të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Ligjin nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standarde të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi pëmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të Tjera

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe publikimin e informacioneve të tjera. Informacionet e tjera të marra deri në datën e këtij raporti auditimi përbëhen nga "Pasqyrat plotësuese shoqërore"(Skedule Suplementare), por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin e audituesit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon këto informacione të tjera dhe ne nuk shprehim asnjë lloj sigurie lidhur me to. Si pjesë e auditimit tonë, është përgjegjësia jonë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse, bazuar në informacionin e marrë gjatë auditimit tonë, ato përmbajnë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare ose pasaktësi materiale të dukshme. Nëse arrijmë në përfundimin se në informacionet e tjera ekziston një pasaktësi materiale faktike, ne jemi të detyruar ta raportojmë këtë fakt. Siç paraqitet në pasqyrat plotësuese shoqërore, Shoqëria ka llogaritur "Marzhin e Solvencës dhe aktivet mbuluese të detyrimeve të sigurimit". Nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë drejtim.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me politikat kontabël të përshkruara në Shënimin 2 të pasqyrave financiare, për përcaktimin se baza e përgatitjes është e pranueshme në rrethanat konkrete, si dhe për atë kontroll të brendshëm që drejtimi e konsideron të nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vijuar në vijimësi, për dhënien e informacioneve shpjeguese, sipas rastit, lidhur me vijimësinë dhe për përdorimin e bazës kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi synon të likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë veprimtarinë, ose kur nuk ka alternativë reale tjetër veçse të veprojë në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Opiniononi i Shoqërisë Audituese

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të sigurojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare, si tërësi, janë pa anomali materiale, qoftë për shkak mashtrimi apo gabimi, dhe të lëshojmë një raport audituesi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk është garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të pritet në mënyrë të arsyeshme që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare me qëllim të përgjithshëm.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomali të materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi në përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe sigurojmë evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i mosidentifikimit të një anomalie materiale që rrjedh nga mashtrimi është më i lartë sesa për një anomali që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, paraqitje të pasakta ose tejkalim të kontrolleve të brendshme.

- Sigurojmë një kuptim të kontrollit të brendshëm që është i rëndësishëm për auditimin, me qëllim projektimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat konkrete, por jo me qëllim shprehjen e një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të informacioneve shpjeguese përkatëse të bëra nga drejtimi. Arrijmë në një përfundim mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga drejtimi të bazës kontabël të vijimësisë dhe, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vijuar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se ekziston një pasiguri materiale, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit mbi informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të mos jetë më në gjendje të vijojë në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese, si dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në një mënyrë që siguron paraqitje të drejtë.

Raport mbi Përputhshmërinë me Kërkesat Ligjore dhe Rregullatore

Në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë për njësitë me interes publik, deklarojmë se:

- Emërimi i Audituesit: Ne jemi emëruar si auditues ligjor nga Asambleja e Aksionarëve më datë 18.10.2024 dhe kemi shërbyer si auditues të Shoqërisë për një periudhë të pandërprerë prej 2 vitesh, duke përfshirë rinovimet përkatëse.
- Raporti Shtesë për Komitetin e Auditimit: Opinioni ynë i auditimit mbi pasqyrat financiare është në përputhje me raportin shtesë të përgatitur për Komitetin e Auditimit, në përputhje me kërkesat e Rregullores nr. 44, datë 30.09.2025, të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.
- Shërbime Jo-Auditimi: Gjatë periudhës së angazhimit ne nuk kemi ofruar asnjë shërbim jo-auditimi të ndaluar. Çdo shërbim tjetër i ofruar, nëse ka, është kryer në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe rregulloreve të zbatueshme.
- Pavarësia: Ne kemi mbetur të pavarur gjatë gjithë periudhës së angazhimit, në përputhje me kërkesat etike, ligjore dhe rregullatore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

31 mars 2026

Grant Thornton sh.p.k.



Ergana Isufi
Jh

Pasqyrat Financiare

Pasqyrat Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe Skedulet Suplementare më 31 dhjetor 2025

Shënimi	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
AKTIVET		
Aktivët afatgjatë materiale	7 31,961	0
Aktivët afatgjatë jo-materiale	8 16,212	0
Depozita me afat në banka	9 400,330	397,528
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	11 584	0
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit	12 3,612	0
Aktive të tjera	10 66	0
Aktive të risigurimit	0	0
Aktiv tatimor i shtyre	4,381	3,545
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	13 1,310	46,918
TOTALI I AKTIVEVE	458,456	447,991
KAPITALI		
Kapitali aksionar	0 468,000	468,000
Fitim/Humbje të mbartura	(20,117)	0
Fitim/Humbje i vitit	(4,865)	(20,117)
TOTALI I KAPITALIT	443,018	447,883
DETYRIMET		
Rezervat teknike të sigurimit	0 42	0
Rezervat matematikore	0 1,656	0
Rezerva për primet e paguara	0 5,291	0
Detyrime të tjera	15 8,449	108
Detyrime tatimore të shtyra	0	0
TOTALI I DETYRIMEVE	15,438	108
TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE	458,456	447,991

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i shoqërisë më datë 30 Mars 2026 dhe nënshkruar në emër të tyre nga:


Albana Meta
Drejtor i Përgjithshëm


Ilir Elmazi
VIG Services SH.P.K.



Shënimi	2025	2024
Prime të shkruara bruto	16 12,353	0
Prime të ceduara të risiguresit	0 (900)	0
Ndryshimi në provizione teknike	0 (5,291)	0
Ndryshimi në provizionet matematikore	0 (1,656)	0
Ndryshimi në rezervat teknike të risiguresit dhe provizionet matematikore		
Prime të fituara neto	4,506	0
Fitim/Humbje nga kurset e kembimit	21 (4,373)	(25,575)
Shpenzime financiare	20 (157)	(36)
Të ardhura nga investimet	17 10,050	2,155
Të ardhura të tjera operative		
Të ardhura neto	10,026	(23,456)
Dëme të paguara, bruto	0 (667)	0
Ndryshimi në rezervën e dëmeve bruto	0 (42)	0
Shpenzime administrative	19 (12,134)	(206)
Shpenzimet e shitjes	18 (2,884)	0
Totali i humbjeve dhe shpenzimeve	(15,727)	(206)
Fitimi para tatimit	22 (5,701)	(23,662)
Tatimi mbi fitimin	22 0	0
Tatimi fitimi i shtyre	22 836	3,545
Fitimi/Humbja e vitit	(4,865)	(20,117)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	(4,865)	(20,117)

Pasqyrat Financiare

	Shënimi	2025	2024
Fitimi para tatimit		(5,701)	(23,662)
Flukset monetare nga aktivitetet operative			
Rregullime për:			
Zhvierësimin dhe amortizimin		3,199	0
Humbje nga zhvierësimi i llogarive të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit		-	-
Humbje nga shitje e aktiveve afatgjata materiale		-	-
Shpenzime interesi		-	-
Të ardhura nga investimet		(10,050)	(2,155)
Efekti nga kursi i këmbimit		4,373	25,575
Flukset monetare nga aktiviteti operativ para ndryshimeve në aktive dhe detyrime		(8,179)	(242)
Ndryshime në aktive të risigurimit	12	(3,612)	-
Ndryshime në aktive të tjera		(66)	-
Ndryshime në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	11	(584)	-
Ndryshime në rezervat teknike dhe matematikore	0	1,656	-
Ndryshime në rezervën e primeve të paguara	0	5,291	-
Ndryshimi në rezerva	0	42	-
Ndryshime në detyrimet tatimore	15	8,341	108
Ndryshime në llogari të pagueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera		-	-
Flukset monetare të gjeneruara nga aktiviteti operativ		2,889	(134)
Interesi i arkëtuar		3,328	-
Interesi i paguar		-	-
Tatimi mbi fitimin i paguar		-	-
Flukset monetare neto nga aktivitetet operative		6,217	(134)
Flukset monetare nga aktivitetet investuese			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	7	(32,869)	-
Blerje e aktiveve afatgjata jo-materiale	8	(18,503)	-
Blerja e letrave me vlerë të investimeve me kosto të amortizuar		-	-
Maturimi i investimeve me kosto të amortizuar		-	-
Ndryshime në depozitat me afat në banka	9	3,920	(395,373)
Ulje në investimet në pjesëmarrje		-	-
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese		(47,452)	(395,373)
Flukset monetare nga aktivitetet finacuese			
Pagesat e qirave		-	-
Dividend i paguar		-	-
Arkëtime neto nga emetimi i kapitalit aksionar		-	468,000
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet finacuese		-	468,000
Translation effect		(4,373)	(25,575)
Rritja neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre		(45,608)	46,918
Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të vitit		46,918	-
Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të vitit		1,310	46,918

Objektivat 2026

<i>Balance Sheet in thousand ALL</i>	<i>01-12 2025</i>	<i>01-02 2026</i>
Assets		
Property and Equipments	31,961	31,449
Intangible assets	16,212	15,441
Term deposits	400,330	398,677
Deferred acquisition costs	584	2,834
Insurance Receivables	3,612	3,756
Other assets	66	490
Reinsurance assets	-	-
Deferred tax asset	4,381	4,381
Cash and cash equivalents	1,310	33,365
Total assets	458,457	490,393
Liabilities		
Insurance contract liabilities	42	184
Mathematical provisions	1,656	2,371
Unearned premium reserves	5,291	11,535
Other liabilities	8,449	9,717
Short term Loans	-	30,000
Total liabilities	15,438	53,807
Shareholder's equity		
Share capital	468,000	468,000
Loss/Profit of prior year	(20,117)	(24,982)
Loss/Profit of the year	(4,865)	(6,433)
Total shareholder's equity	443,018	436,586
Total liabilities and shareholder's equity	458,457	490,393

Vienna Life Insurance Albania

Life profitability

Profit & Loss Account in thousand ALL	01-12 2025	01-02 2026	Plan 2026
Net Earned Premium	4,506	2,803	48,450
Written Premium	11,453	9,762	79,050
Gross written premiums	12,353	10,218	85,000
Premium ceded to reinsurers	(900)	(455)	(5,950)
Change in technical provisions	(5,291)	(6,245)	(30,600)
Change in mathematical provisions	(1,656)	(715)	-
Change Reins.in technical & mathematical provisions	-	-	-
Other operating income	5,520	(386)	10,900
Foreign exchange gain/(loss)	(4,373)	(654)	-
Financial Expenses	(157)	(85)	(300)
Investment income	10,050	353	11,200
Other operating income	-	-	-
Other expenses	(15,727)	(8,850)	(67,825)
Claims Paid gross	(667)	(517)	(6,000)
Change in claims reserve	(42)	(142)	-
Administrative expenses	(12,134)	(6,518)	(44,825)
Acquisition costs	(2,884)	(1,673)	(17,000)
Profit (loss) before income tax expense	(5,701)	(6,433)	(8,475)
Income tax benefit (expense)	-	-	-
Deferred Tax(income/expense)	836	-	-
Net profit (loss) for the year	(4,864)	(6,433)	(8,475)

Vienna Life Insurance Albania

Life Administrative Expenses

Administrative expenses	01-12 2025	01-02 2026	Plan 2026
Personel expenses	3,825	3,281	23,000
Amortization & Depreciation	3,199	1,433	3,000
Marketing expenses	228	25	10,000
Local taxes paid	133	(0)	100
Audit Expenses	778	-	1,000
Financial Services	1,485	726	1,600
IT Costs	715	132	900
Penalties and fines	125	0	-
Maintenance & repairs	108	-	150
Rent & running expenses	327	353	3,000
Insurance Tax 1.5%	185	153	1,275
Office operating	63	124	100
Travel expenses	574	69	200
Own Insurance	61	169	-
Consulting expenses	-	-	-
Other	327	53	500
Total	12,134	6,518	44,825

KONTAKT

Adresa: Rruga "Ismail Qemali", Samos Tower,
Kati i 8-të, Ish-Bllok, Tirane.

Tel: +355 (0) 4 222 8006

E-mail: info@viennalife.al

Publikuar më 30.06.2026

VIENNA LIFE 
VIENNA INSURANCE GROUP

